

NJOFTIM PËR KURS FORMIMI PROFESIONAL

Instituti i Ndërtimit, informon të gjithë personat e interesuar që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e ndërtimit në Shqipëri dhe viset shqipfolëse se kanë filluar regjistrimet për Kursin Profesional për **Laborantë të Produkteve të Ndërtimit**.

Instituti i Ndërtimit njofton se nga fillimi i vitit 2015 e në vazhdim do të bëhet i mundur organizimi i Kursit 3-Mujor Profesional, për të cilin është licensuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës.

Programi i këtyre kurseve përfshin marrjen e njohurive :

Teorike - në fushën e ligjshmërisë, standardeve të produkteve, standardeve të testimit dhe standardeve për funksionimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit; **Praktike** – për teknologjinë e prodhimit, procedurat, pajisjet laboratorike dhe testimin kimik e fiziko-mekanik të lëndëve të para të produkteve të ndërtimit, sipas standardeve evropiane në laboratorët e Institutit.

Laboranti i produkteve të ndërtimit, duke u formuar e specializuar pranë I.N. për disa grup produktesh ndërtimi :

- betone e parafabrikate betoni e beton i armuar
- agregate (nga zhavorr lumi e gur mali)
- tulla, blloqe për soleta, tjegulla, pllaka qeramike
- lidhësa (çimento, kollë, llaçe, etj.)
- asfaltobeton,
- etj.

do të jetë në gjendje të japë kontribut me vlerë pranë kompanive që kryejnë veprimtari prodhuese, tregtuese, kontrolluese e vlerësuese të konformitetit të produkteve të ndërtimit në përputhje me standardet shqiptare e evropiane.

Përgatitja dhe kualifikimi i specialistëve në këtë drejtim, do t'i shërbente rritjes së vëmendjes ndaj cilësisë së produkteve të ndërtimit që prodhohen e përdoren në vend, si një nga kërkesat kryesore për zhvillimin e kësaj dege me rëndësi të ekonomisë së vendit tonë.

Pjesëmarrësit e këtij kursi duhet të kenë përfunduar Universitetin Politeknik ose Fakultetin e Shkencave Natyrore (Dega Kimi), ose të kenë njohuri për produktet e ndërtimit (p.sh. laborantë).

Të interesuarit duhet të paraqesin pranë Institutit të Ndërtimit dokumentet e mëposhtme:

- ✓ Kërkesën me shkrim për kryerjen e Kursit
- ✓ Fotokopje diplome
- ✓ Mjetin e identifikimit (fotokopje)
- ✓ Curriculum Vitae
- ✓ 2 fotografi për dokumenta
- ✓ Të paguajnë tarifën 60 000 lekë (edhe me këste) Kursi zhvillohet 2 herë në javë (të shtunë, të djelë)

Për informacion të mëtejshëm të interesuarit mund të drejtohen pranë Institutit të Ndërtimit ose të na kontaktojnë në faqen tonë të internetit:

www.institutindertimit.al

e-mail: constructionsinstitute@yahoo.com

Ose në numrat e telefonit:

+355 4 2273449

+355 66 4023305

+355 66 4023341

REGJISTROHU DHE PËRFITO	
EDUKIM	<input checked="" type="checkbox"/>
TRAJNIM	<input checked="" type="checkbox"/>
PRAKTIKË	<input checked="" type="checkbox"/>
KARRIERË	<input checked="" type="checkbox"/>